

VENDIM
Nr. 868, datë 24.12.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM
NOTASH, TË MARRËVESHJES SË HUAS, TË DATËS 25 KORRIK 2014,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN E SHËRBIMEVE
MJEDISORE, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 151/2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 151/2014, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e shërbimeve mjedisore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim notash, të marrëveshjes së huas, të datës 25 korrik 2014, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e shërbimeve mjedisore, ratifikuar me ligjin nr. 151/2014, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Banka Botërore
IBRD • IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE
Pratertrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020
LINDA VAN GELDER
Drejtore Rajonale për Ballkanin Perëndimor, Evropën dhe Azinë Qendrore

30 shtator 2019

Sh. s. Anila Denaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë, Shqipëri

E nderuar znj. Ministre,
Projekti i shërbimeve mjedisore në Shqipëri
IBRD Huaja 8401-AL
Rialokimi i të ardhurave të huas dhe zgjatje e afatit të mbylljes

Referuar marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), datë 25 korrik, 2014, për projektin e shërbimeve mjedisore (Projekti) dhe letrës suaj, datë 12 shtator 2019, ku Bankës Botërore i kërkohet rialokimi i të ardhurave të huas midis kategorive të disbursimit, si edhe zgjatje të afatit të mbylljes, nga 30 shtator 2019, deri në datën 30 shtator 2020.

Kemi kënaqësinë t’ju njoftojmë se Banka Botërore bie dakord me kërkesën tuaj dhe:

a) rialokon të ardhurat e huas sipas paragrafit IV.A.2, të skedulit të marrëveshjes së huas, siç përcaktohet në shtojcën 1 të kësaj letre; dhe b) cakton datën 30 shtator 2020, si datë të mëvonshme për qëllime të paragrafit IV.B.2, të skedulit 2, të marrëveshjes së huas.

Me respekt,
Nënshkrimi
Linda Van Gelder
Drejtoresha Rajonale për Ballkanin Perëndimor, Evropën dhe Azinë Qendrore

Në vëmendje të: Sh. s. Blendi Klosi - Ministër i Turizmit dhe Mjedisit
Z. Erjon Luci - Zëvendësministër i Financave
Znj. Petra Burcher - Shefe e Bashkëpunimit për Zhvillim, Ambasada Suedeze
Z. Tomas Nystrom - Drejtues i Programit, Ambasada Suedeze
Znj. Majlinda Dhuka - Zv. Sekretare e Përgjithshme dhe Drejtore e Përgjithshme e Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje
Z. Patrizio Pagano - Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore
Sh. s. Anila Denaj

Sh. s. Anila Denaj

30 shtator 2019

Tabela në paragrafin IV.A.2, të skedulit 2, të marrëveshjes së huas, është ndryshuar si më poshtë:

Kategoria	Shuma e grantit të alokuar shprehur në euro	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar (duke përfshirë taksat)
1. Materiale dhe shërbime jokonsulente sipas pjesës 1/a, pjesës 2/c dhe pjesës 4/a, të projektit	5,239,472/93	100%
2. Nënprojekte sipas pjesës 2/b të projektit	2,042,277.07	100%
3. Tarifa fillestare	18,250	Shuma e pagueshme sipas paragrafit 2.3 të kësaj marrëveshje, në përputhje me paragrafin 2.07/b të Kushteve të Përgjithshme
Shuma totale	7,300,000	

Sh. s. Anila Denaj
Miratuar nga: Kseniya Lvovsky, Menaxhere e Praktikave, GENEK - Damir Leljak (WFACS)

Për dijeni: Linda Van Gelder, Maryam Salim, Kseniya Lvovsky, Luis M.Schwarz, Damir Leljak, Drita Dade, Silvia Mauri, Arben Maho, Jonida Myftiu, Bekim Imeri, Esma Kreso, Elona Qana, Simon Ellis, Lada Strellkova, Goran Tinjic, Daria Lavrentieva, Valentina Martinovic, Nejme Kotere, Evis Sulko, Luz Meza-Bartrina, Nadeem Mohammad, Albania DL, ECA Operations, Drejtor GENEK GP, ECCWB Ekipi Manaxherial (ECCWB DMT), WB Docs.

Person kontakti: Drita Dade (numri i brendshëm: 5246 137)

